

POP 5


Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1




Rudina Hajdari reagon për largimin e nënës së saj nga Drejtësia: Ata që m'u hodhën si ujçër, e morën përgjigjen! Besoj te Reforma (VIDEO)

2



Vëllai dhe nipi marrin hakun për vrasjen e Prel Markut në Angli, arrestohet 22-vjeçari bashkëpunëtor në Hekuran Billës, sinkronizoi lëvizjet (Detajet)

3



Vettingu i zbuloi luksin: SHBA i refuzoi vizën! Fatmira Hajdari përlotet: Betohe m për ndeshmëri, Berisha më ndihmoi me kredi

4



Kryeprokurori Ulet krimi me vend! Sistemi drejtësisë ka mbikëqyrret

SH

COM

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Aktualitet

Grabitet me armë zjarri një postë private tek ish-sheshi 'Shqiponja', policia në ndjekje të dy autorëve! Kamerat e sigurisë fiksuan ngjarjen (VIDEO)

Një grabitje me armë zjarri ka ndodhur mbrëmjen e sotme në një postë private në Tiranë. Burime për Report Tv bëjnë të ditur se dy persona ende të paidentifikuar kanë hyrë brenda ambienteve të postës dhe nën kërcënimin e armës kanë marrë një sasi lekësh që ishin mbi banak.

Grabitet me armë zjarri një postë private . ish-sheshi 'Shqiponja', policia në ndjekje të a...



SH

COM

Redaksia

16 Qershor, 22:15 | Përditësimi i fundit: 16 Qershor, 23:33

Share 40

Tweet

Një grabitje me armë zjarri ka ndodhur mbrëmjen e sotme (16 qershor) në një postë private në Tiranë. Burime për Report Tv bëjnë të ditur se dy persona ende të paidentifikuar rreth orës 22:00 kanë hyrë brenda ambienteve të postës dhe nën kërcënimin e armës kanë marrë një sasi lekësh që ishin mbi banak.

Nuk dihet ende sasia e lekëve të marrë në postë, por mësohet se pas grabitjes autorët janë larguar me një motoçikletë. Shërbimet e policisë kanë shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes dhe pasi kanë rrethuar zonën me shiritin e sigurisë janë vënë në ndjekje të autorëve.

SH

COM

LEXO EDHE:
Sherr me shpulla mes dy stomatologeve në Qendrën e Shërbimit Mjekësor



Gazetari i Report TV, Merin Maçi raporton se kanë qenë punonjësit e postës që kanë njoftuar policinë, e cila pasi ka mbërritur në vendin e ngjarjes ka sekuestruar edhe kamerat e sigurisë, që kanë fiksuar grabitjen.

Fakti që autorët kanë vepruar në orët e vona të natës, tregon që ata e kanë studiuar mirë zonën dhe kanë pritur që posta të mos ketë shumë punëtorë.

Blutë e kryeqytetit kanë ngritur pika të shumta kontrolli në disa akse kryesore për të bërë të mundur arrestimin e autorëve.

Grabitet me armë zjarri një postë private tek ish-sheshi 'Shqiponja' (FOTO)



Share 22

Në vendin e ngjarjes shkoi edhe Zëvendësdirigjenti i Policisë për Sigurinë Publike, Dhimitraq Ziu.

Njoftimi i policisë së Tiranës
Në datë 16.06.2020, rreth orës 21:50, prane sheshit "Shqiponja", në një zyrë postare private, dyshohet se dy persona ende të paidentifikuar, nën kërcënimin e armës kanë vjedhur një sasi lekësh dhe janë larguar me një mjet motoçikletë.

Në të gjitha hyrje-daljet e Tiranës, janë ngritur pika kontrolli. Policia ka shpërndarë në këto pika, identifikimet e autorëve.

Forcat e Policisë po krehin zonën dhe vijojnë kontrollet edhe në parkingje e ambiente të ndryshme.

Grupi hetimor vijon punën për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, me qëllim identifikimin e autorëve.

Policia e Shtetit fton çdo qytetar që mund të ketë të dhëna mbi autorët, të telefonojnë falas në 112, duke u garantuar anoniminat.

Report TV -Grabitet me armë zjarri një postë private tek ish-sh...



Share 54

m.x./a.ca./Shqiptarja.com

TAG:

tirane

grabitet posta

sheshi shqiponja

grabitje me arme

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

COM

Sondazhi i ditës:
A duhet të hapet transporti publik dhe ai ndërqytetas?

Po

Jo

Nuk e di

Komento

Komente

Labi:

17/06/2020 01:30

Hajde meksika ka namin me frym popullsie me atentate grabitej perdhunime korrupsion vjedhje plagosje vrasje mashtirme ska shanc jemi te par ne bot te pakten jemi 1 ne kete fush

Përgjigju

Mili:

16/06/2020 22:40

Nqse kapen dhe denohen atehere sipas ish ambasadorit britanik keta duhen leshuar sepse janë ordinere. Ish ambasadori britanik për mediat shqiptare tha dikur se në burgjet e Shqiperise ka keqberes ordinere të denuar me shume e shume vite te cilet duhet të riintegrohen në shoqeri. Tani me thonë ju a behen njerëz keta

Përgjigju

Zani:

17/06/2020 07:42

O Mili, ambasadori e kishte per ata qe denohen per perdorim te lendve narkotike ,vjedin energjine apo bejne krime ekonomike.Kemi numrin me te madh te te burgosurve ne rajon per numer popullsie.Por nese mendon se e kishte me keta,vazhdo e mendoje se je ne rregull.

Agron:

16/06/2020 23:39

Bravo e gjete, ish ambasadori britanik na e ka fajin. Edhe shoku Enver ka folur per rrezikun Anglo-Amerikan mbi Shqiperine.

Lajme të tjera



Murrisi:Prokuroria është zhveshur nga të gjitha kontributet! Çela: Po përjeton ndryshim thelbësor!
18 Qershor, 14:12



Ndotja e mjedisit/ Pas kompanisë së pastrimit, IKMT gjobit bashkinë e Rrogozhinës
18 Qershor, 14:12



Kryeprokurori Çela: Ulet krimi me 2% në vend! Sistemi i drejtësisë ka nevojë të mbikëqyrret
18 Qershor, 14:49



Valteri për Report Tv: Videon që publikova e ka policia! Do e nxjerrë për mediat pasi të jap deklaratën në prokurori
18 Qershor, 13:44



Publikoi video nga atentati ndaj prokurorit/ SPAK-Halit Valterit: Eja sill provat dhe dëshmo çfarë di
18 Qershor, 12:13



Stafi mjekësor i Vlorës preket nga COVID-i, infektet mamia dhe punonjësja e qendrës shëndetësore në lagje
18 Qershor, 12:09

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje